

**VENDIM**  
**Nr.745, datë 15.9.2010**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, lejohen të gjitha autoritetet kontraktore të vijojnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për të gjitha blerjet me vlerë më të vogël se 400 000 (katërqind mijë) lekë.

Përjashtimisht, lejohet Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektet e mëposhtme:

- i) “Blerje materialesh elektronike profesionale”;
- ii) “Blerje pjesësh këmbimi për automjete”;
- iii) “Blerje materialesh elektrike”;
- iv) “Kontrata për shërbimin e internetit, me kohëzgjatje 16 muaj”;
- v) “Shërbimi celular për administratën e Kuvendit”.

Përjashtimisht, lejohet Ministria e Shëndetësisë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

- i) “Blerje materialesh konsumi mjekësor për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut”;
- ii) “Blerje kit-esh dhe reagent-esh për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut”;
- iii) “Blerje kit-esh për agjentët infektivë të kontrollit të gjakut, për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut”;
- iv) “Blerje kit-reagent-esh dhe materialesh konsumi, për laboratorët e drejtorive të shëndetit publik”;
- v) “Blerje vajguri JET A1, për helikopterët e Njësisë së Transportit Mjekësor me Helikopter”;
- vi) “Kryerje e implantit koklear për disa fëmijë”;
- vii) “Blerje vaksinash të rralla antirabike dhe sezonale”.

Përjashtimisht, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

- i) “Mirëmbajtje e sistemeve të peshimit”;
- ii) “Blerje vulash metalike për maunet, plumbçe”.

Përjashtimisht, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin: “Shërbim i ruajtjes me rojë private”.

Përjashtimisht, lejohet Gjykata e Lartë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

- i) “Rikonstrukcion i mjediseve në Gjykatën e Lartë”;
- ii) “Blerje pajisjesh elektronike për Gjykatën e Lartë”;

iii) “Blerje karburanti për Gjykatën e Lartë”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin: “Rikonstruksion dhe objekt i ri, Gjykata e Shkallës së Parë, Vlorë”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

i) “Blerje mobilie dhe pajisjesh elektronike, për ndërtesën e re të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë”;

ii) “Blerje pajisjesh elektronike për ndërtesën e re të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

i) “Krijimi i mjedisit të shërbimit ndaj publikut në dhomën penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë”;

ii) “Studim fizibiliteti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë”;

iii) “Hartimi i projektzbatimit për krijimin e mjedisit të shërbimit ndaj publikut në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë”;

iv) “Blerje mobilie”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin: “Hartimi i projektzbatimit për ndërtesën e re të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin: “Hartimi i projektzbatimit për rikonstruksionin e ndërtesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Pukë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin: “Hartimi i projektzbatimit për rikonstruksionin e ndërtesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Pukë”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Përmet, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

i) “Blerje pajisjesh elektronike”;

ii) “Blerje mobilie zyre”.

Përfundimisht, lejohet Prokuroria e Përgjithshme, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektet e mëposhtme:

i) “Rikonstruksion i tarracës së ndërtesës dhe garazheve të Prokurorisë së Përgjithshme”;

ii) “Blerje pajisjesh kompjuterike”;

iii) “Ndërtimi i ndërtesës së re të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Korçë”;

iv) “Rikonstruksion i ndërtesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Kurbin”;

v) “Projekt i ndërtesës së re të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Shkodër”.

Përfundimisht, lejohet Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, me fondin limit 36 719 828 (tridhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e tetë) lekë, për objektet e mëposhtme:

i) “Linja të tensionit të lartë për PKK-në, Kukës”, me fond limit 11 339 110 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e dhjetë) lekë;

ii) “Trajnime për Oraclin dhe Memexin”, për specialistët e teknologjisë së informacionit, me fond limit 1 970 000 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë;

iii) “Blerje materiale për prodhimin e vulave”, me fond limit 1 783 243 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë;

iv) “Shërbim për licencat “Oracle””, me fond limit 5 627 475 (pesë milionë e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë;

v) “Servera për sistemin “Memex””, me fond limit 5 000 000 (pesë milionë) lekë;

vi) “Shërbim interneti për Policinë e Shtetit”, me fond limit 9 000 000 (nëntë milionë) lekë;

vii) “Riparim kamerash termike”, me fond limit 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë;

viii) “Shtypshkrime për Policinë Kriminale”, me fond limit 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë.

Përfundimisht, lejohet Drejtoria e Policisë së qarkut të Durrësit, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektin “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit”, me fond limit 2 000 000 (dy milionë) lekë.

Përfundimisht, lejohet Drejtoria e Policisë së qarkut të Elbasanit, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektin “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit”, me fond limit 2 484 500 (dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind) lekë.

Përfundimisht, lejohet reparti i policisë, RENE, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin “Sigurim helikopteri”, me fond limit 7 000 000 (shtatë milionë) lekë.

Përfundimisht, lejohet Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit të Ministrisë së Brendshme, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

i. “Blerje filtrash për automjete”, me fond limit 3 508 181 (tre milionë e pesëqind e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekë;

ii. “Blerje pjesësh këmbimi për automjete”, me fond limit 2 572 218 (dy milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

Përfundimisht, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për projektin “Rikonstruksioni i ndërtesës nr.3 në IEVP-në, Lezhë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**